



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
ZYRA ARSIMORE LUSHNJE
TESTI I OLIMPIADËS KOMBËTARE TË GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË
FAZA E I KLASA E XII

Dt. 18.12.2018

Librat dhe bibliotekat

Biblioteka është një institucion, që merret me grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e librave, revistave e të botimeve të tjera, duke i bërë të njohura në masat e gjera dhe duke ua dhënë lexuesve përkohësisht për t'i shfrytëzuar.

Sot disa biblioteka janë bërë jashtëzakonisht të mëdha. Imagjinojeni veten duke qëndruar pranë një rafti 850 kilometra të gjatë dhe që mban mbi 29 milionë libra! Kjo është me përafërsi madhësia e bibliotekës më të madhe në botë. Biblioteka ka rreth 2,7 milionë kaseta dhe vidiokaseta, 12 milionë fotografi, 4,8 milionë harta dhe 57 milionë dorëshkrime. Çdo ditë koleksionit të bibliotekës i shtohen 7 000 artikuj.

Biblioteka Britanike në Londër, renditet e dyta për numrin e librave që ka, më shumë se 18 milionë kopje. Biblioteka Shtetërore Ruse, që ndodhet në Moskë, ka 17 milionë libra dhe një koleksion me rreth 632 000 vëllime vjetore të gazetave. Biblioteka Kombëtare e Francës, një nga bibliotekat më të lashta që ka mbijetuar në Evropë, ka 13 milionë libra. Ajo ishte e para që hodhi në internet shumë prej koleksioneve të saj, duke lehtësuar si asnjëherë më parë hyrjen në fondin e njohurisë së njerëzimit.

Sot më shumë se kurrë, ka një vërshim informacionesh në dispozicion të publikut. Është llogaritur se i gjithë arsenali i librave dyfishohet çdo katër vjet e gjysmë. Vetëm në Shtetet e Bashkuara, çdo vit botohen më shumë se 150 000 libra.

Ende sot, bibliotekat vazhdojnë të jenë “porta drejt njohurisë”. E gjithë mençuria njerëzore ruhet nëpër libra, kurse librat mbahen nëpër biblioteka.

Bibliotekat ndahen në të mëdha dhe të vogla. Për të gjetur një libër, në bibliotekën e vogël të shtëpisë, është mjaft e lehtë. Po si mund ta gesh kur në bibliotekë ndodhen mijëra libra? Po në qoftë se ata janë qindra mijëra? Po nëse janë miliona? Në këtë rast, kujtesa njerëzore nuk të ndihmon. Si kujtesë e bibliotekës shërben katalogu. Pikërisht ai “i mban mend” të gjithë librat që ndodhen në raftet e bibliotekës. Fjala “katalog” vjen nga greqishtja dhe do të thotë “listë”, pra lista e të gjithë librave të bibliotekës.

Në qoftë se na duhet të gjejmë dikë, para së gjithash pyesim për adresën e tij. Edhe në bibliotekë, çdo libër ka “adresën” e tij, sepse biblioteka është shumë e ngjashme me një qytet, me një “lagje” dhe me një “rrugë”. Pra, librat në raftet nuk qëndrojnë pa rregull, por sipas një numri të saktë, pikërisht si shtëpitë në rrugë. Në qoftë se do të mësoni ta përdorni saktë katalogun, atëherë do ta keni shumë të lehtë për të gjetur librin që ju duhet, aq më tepër që në çdo bibliotekë, për të njëjtin libër, përdoret e njëjta “adresë”.

1. Teskti “Librat dhe bibliotekat” është tekst joletrar:

1 pikë

- a) informues-paraqitës b) përshkrues c) argumentues d) udhëzues

2. Ky tekst i drejtohet:

1 pikë

- a) një studenti që mbron një temë shkencore
b) një studiuesi të letërsisë
c) një anëtari të ri të bibliotekës
d) kujtdo që do të dijë më shumë për librat dhe bibliotekat

3. Teskti në pesë paragrafët e tij të parë ka për qëllim:

1 pikë

- a) të japë informacione për hovin dhe zhvillimin e bibliotekave botërore
b) të sjellë informacione për hapat që duhen ndjekur për të gjetur një libër në bibliotekë
c) të ftojë lexuesit të lexojnë sa më shumë libra
d) të paralajmërojë një bibliotekare të re për vështirësitë e punës në bibliotekë.

4. Regjistri gjuhësor i tekstit është:

1 pikë

a) ironik

b) shkencor

c) publicistik

d) I përgjithshëm

5. Elementi i skemës së komunikimit të cilit i kushtohet më shumë vëmendje në këtë tekst është:

4.1. a) kodi

b) kanali

c) dhënësi

d) refenti

1 pikë

4.2. Identifikojeni atë: _____

1 pikë

6. Ç'veçori strukturore dhe gjuhësoro-stilistike ka paragrafi I karahasuar me paragrafët e tjerë vijues?

2 pikë

Vecori strukturore _____

Vecor gjuhësoro-stilistike _____

7. Lexoni me vëmendje paragrafin VI. Zbuloni në të një veçori leksikore, një veçori morfologjike, një veçori sintaksore karakteristike për këtë lloj teksti joletrar.

Veçori leksikore _____

Veçori morfologjike _____

Veçori sintaksore _____

3 pikë

8. a Cilës klasë fjale i përket fjala e nënvizuar në fjalinë: “Biblioteka Kombëtare e Francës, një nga bibliotekat më të lashta që ka mbijetuar në Evropë, ka mbi 13 milionë libra”?

Klasa e fjalës _____

1 pikë

8.b Rishkruaje fjalinë e mësipërme duke e shkruar emërtimin e institucionit Biblioteka Kombëtare e Francës si shkurtesë (akronim).

Fjalja e rishkruar: _____

1 pikë

9.a Në paragrafin VI fjala si përdoret dy here. Identifikoni klasën e kësaj fjale (për secilën fjalë).

a) Po si mund ta gjesh kur në bibliotekë ndodhen mijëra libra.

b) Si kujtesë e bibliotekës shërben katalogu.

Fjalja I _____

Fjalja II _____

2 pikë

9.b Në cilin rast fjala si është jo e parme. Si është formuar ajo?

Jo e parme _____ formimi _____ 2 pikë

10. Në fjalinë: “Librat në rafte nuk qëndorjnë pa rregull, por sipas një numri të saktë, pikërisht si shtëpitë në rrugë”, fjala rafte ç’gjymtyrë fjalie është?

në rafte _____

1 pikë

11. Në paragrafin e fundit gjeni dy kallëzues të formuar me foljen duhet, emërtoni llojin e tyre dhe tregoni kuptimin e kësaj foljeje.

1. _____

2. _____

4 pikë

GJUHË E ZJARRTË

O gjuhë-e shenjtëruar, o mall me shpirtin plot.
O vetëtim´ e qjellit që fërfëllon me flakë,
O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot...
Si pikë lot e ndritur po ndrij në reze t´uaj,
Po ndrij e papandehur po qaj pak e nga pakë
Sepse prej botës s´uaj kam mbetur kaq i huaj...

Kam mbetur kaq i huaj, dh´i ndrydhur edh´i shkret!
Prej ligjëratës s´ate që më çudit, o zjarr!
Me gjuhëra prej flakë ti djeg... ti flet... ti pret...
Do vi! do të vi pranë mjerush e dyke vuar,
E flakën vraparake në kraha do t´a marr,
Pasi kuvend të shkruar do të t´a çik me duar.

O këng´ e shenjtëruar, o verb i larë n´ar.
O zjarr që më përflakesh si yll vetëtimtar.
O fshehtësir´ e ndezur në fill prej shkrepëtime.
Kur të këndoje me gojë, kur të kuptoj në kartë,
Posi një kraharuar ti dhemb, o Gjuhë-e zjartë,
Pasi kullim´i gjakut që rreh në zemër t´ime.

Ti ndrin në thelb të jetës si dritë-e përvëluar,
O gjuhë-e zemrës s´ime, o mos-e-kuvënduar.

- 1. Lasgush Poradeci është përfaqësues i:** **1 pikë**
A) letërsisë së vjetër shqiptare. B) poezisë tradicionale shqiptare.
C) prozës moderne shqiptare. D) poezisë moderne shqiptare.
- 2. Kjo poezi bën pjesë në:** **1 pikë**
A) lirikën filozofike B) lirikën e peizazhit
C) lirikën erotike D) lirikën shoqërore
- 3. Cilin autor nga letërsia e traditës ju kujtojnë këto vargje:** **1 pikë**
O gjuhë-e zemrës s´ime, o mos-e-kuvënduar.
A) Ndre Mjedën B) Gjergj Fishtësn
C) Naim Frashërin D) Asdrenin
- 4. Cili është mjeti stilistik i përdorur në dy vargjet e dhëna:** **1 pikë**
O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot...
Si pikë lot e ndritur po ndrij në reze t´uaj,
A) epanastrofeja B) alegoria
C) hiperbola D) epanalepsa
- 5. Cila janë cilësitë e gjuhës së zjarrtë, sipas vargjeve:** **3 pikë**
O gjuhë-e shentëruar, o mall me shpirtin plot.
O vetëtim´ e qjellit që fërfëllon me flakë,
O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot...

Cilësitë _____

6. Gjeni dhe komentoni lidhjen që vendoset midis vargut të parë dhe të dytë (bazohuni te kuptimi i fjalëve pikë loti): **2 pikë**

O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot...

Si pikë lot e ndritur po ndrij në reze t' uaj

7. Gjeni kuptimin e fjalëve i ndrydhur, i shkretë në vargun e mëposhtëm. Cila është fjala kyç e vargut që krijon këto gjendje? **1 pikë**

Kam mbetur kaq i huaj, dh' i ndrydhur edh' i shkret!

Fjala kyç: _____

1 pikë

Kuptimi i fjalës *i ndrydhur* _____

Kuptimi i fjalës *i shkretë* _____

1 pikë

8. Jepni një sinonim kontekstual të fjalës çudit dukeu mbështetur në kuptimin e vargut:

“Prej ligjëratës që më çudit, o zjarr!”

1 pikë

Sinonim kontekstual: _____

9. Pse Lasgushi përdor karakterizimetë tilla për veten : “mjerush” e “dyke vuar” (ndërkohë që jemi mësuar ta përfytyrojmë poetin madhështor dhe t’i vemë kaarakterizime analoge)? **2 pikë**

10. Cilat janë mënyrat e shfaqjes së një gjuhe? Gjeni vargjet ku duken ato.

Mënyra e shfaqjes së gjuhë janë: _____

2 pikë

Vargjet: _____

1 pikë

11. Ç’kuptim ka karahasimi i vargut:

Posi një kraharuar ti dhemb, o Gjuhë-e zjartë

2 pikë

12. Argumentoni në formën e një eseje mendimin e L.Poradecit për cilësitë e kësaj, që e bëjnë atë mos-të-kuvenduar

8 pikë